



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
EKIPI TEMATIK
MONITORIMI I STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE PËR MBROJTJEN
E VIKTIMAVE TË KRIMIT 2024 – 2030

5938
Nr. ___prot

Tiranë më 15 . 11 . 2024

Vendim

Nr. 66, datë 15, 11, 2024

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË MONITORIMIT PËR PERIUdhËN JANAR-QERSHOR
2024, PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE PËR MBROJTJEN E
VIKTIMAVE TË KRIMIT**


Në mbështetje të vendimit Nr. 729, datë 13.12.2023 të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024–2030, të Planit të saj të Veprimit dhe të Pasaportës së Treguesve”, urdhërit të Kryeministrit Nr. 90, datë 01.08.2023 “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar”, Ekipi Tematik për monitorimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024-2030,

VENDOSI:

1. Miratimin e Raportit të Monitorimit për periudhën janar-qershor 2024, për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit dhe të Planit të saj të Veprimit 2024-2030.
2. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë të publikojë Raportin e Monitorimit për periudhën janar-qershor 2024, në faqen zyrtare të saj.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij.

ZËVENDËSMINISTËR

Klajd Karameta





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË

RAPORT MONITORIMI JANAR – QERSHOR 2024

**Strategjia Ndërsektoriale për Mbrojtjen e
Viktimave të Krimit 2024 – 2030**

www.drejtesia.gov.al

Tabela e Përmbajtjes

Tabela e Përmbajtjes	2
I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE MBI MONITORIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE PËR MBROJTJEN E VIKTIMAVE TË KRIMIT DHE PLANIT TË VEPRIMIT 2024 – 2030, PËR PERIU DHËN JANAR - QERSHOR 2024.	6
II. METODOLOGJIA E MONITORIMIT.....	9
III. PROGRESI I ZBATIMIT SIPAS QËLLIMEVE.....	12
I. Qëllimi i Parë i Politikës	12
II. Qëllimi i Dytë i Politikës.....	16
III. Qëllimi i Tretë i Politikës.....	18
IV. Qëllimi i Katërt i Politikës.....	21
IV. KONKLUZIONE	22
V. SFIDAT	23

SHKURTIME

AAPSK	Agjencia e Administrimit të Pronave të Sekuestruara dhe të Konfiskuara
AKR	Agjencia Kombëtare e Rinisë
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
AMA	Autoriteti Mediave Audiovizive
AMVV	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjen Vendore
AP	Avokati i Popullit
AS	Akademia e Sigurisë
ASCK	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror
ASHDMF	Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës
BE	Bashkimi Evropian
CPT	Komiteti për Parandalimin e Torturës
QKEDH	Qendra Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm
DNJF	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas
DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
DPP	Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
DPSHP	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës
DAP	Departamenti i Administratës Publike
DHASH	Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë
DHKN	Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve
GREVIO	Grupi i Ekspertëve të Këshillit të Evropës për Masat kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje
GRETA	Grupi i Ekspertëve mbi Veprimin kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore
GjEDNj	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
IAL	Institucione të Arsimit të Lartë
IML	Instituti i Mjekësisë Ligjore
INSTAT	Instituti i Statistikave i Republikës së Shqipërisë
KDIMDP	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
KDPM	Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur

KP	Kodi Penal
KPP	Kodi Procedurës Penale
KiE	Këshilli i Evropës
KKBDF	Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve
KMD	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
KLGG	Këshilli i Lartë Gjyqësor
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KM	Këshilli i Ministrave
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
MB	Ministria e Brendshme
MD	Ministria e Drejtësisë
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MSHRF	Ministër i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MEVPI	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
M&V	Monitorim dhe Vlerësim
NJVV	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
OJF	Organizata Jo Fitimprurëse
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
OZHQ	Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PKIE	Plani Kombëtar të Integritit Evropian
PP	Prokuroria e Përgjithshme
PV	Plani i Veprimit
PMF	Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës
QPKMR	Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve
QTI	Qendra e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë
RSH	Republika e Shqipërisë
RTSH	Radio Televizioni Shqiptar

SASPAC	Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe e Koordinimit të Ndihmës
SPAK	Struktura e Posaqme Kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit
SthCh	Save the Children
SHM	Shkolla e Magjistraturës
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
TdH	Terre des Homes
UEM	Urdhri Evropian i Mbrojtjes
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
UP	Urdhri i Psikologut
UPS	Urdhri i Punonjësit Social
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE MBI MONITORIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE PËR MBROJTJEN E VIKTIMAVE TË KRIMIT DHE PLANIT TË VEPRIMIT 2024 – 2030, PËR PERIUdhËN JANAR - QERSHOR 2024.

Këshilli i Ministrave ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për forcimin e sistemit të drejtësisë dhe mbrojtjen e viktimave të krimit, duke përshtatur legjislacionin vendas me standardet e Bashkimit Evropian (BE) dhe duke forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar. Ky përkushtim rrjedh nga procesi i integritetit të Shqipërisë në BE, ku mbrojtja e të drejtave themelore është pjesë e Kapitullit 23 të acquis, dhe Ministria e Drejtësisë (MD) ka rolin kryesor në këtë proces. Një nga detyrat kryesore është mbrojtja dhe fuqizimi i pozitës së viktimave të krimit në sistemin e drejtësisë.

Si rezultat, është zhvilluar për herë të parë Strategjia Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit (SNMVK) për periudhën 2024-2030 miratuar me vendimin nr. 729, datë 13.12.2023, ka miratuar Strategjinë Ndërsektoriale Për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit dhe Planin e saj të Veprimit., e cila është në linjë me strategjinë e BE-së "Për të Drejtat e Viktimave 2020-2025" dhe aktet lidhur me acquis të BE-së për mbrojtjen e viktimave. Kjo strategji përfshin masa të qarta që synojnë fuqizimin e pozitës së viktimave në sistemin penal, duke siguruar që ata të informohen, të kenë qasje në drejtësi, dhe të marrin shërbimet e nevojshme për rehabilitimin. Gjithashtu, SNMVK synon parandalimin e riviktimizimit dhe viktimizimit të dytë të viktimave.

Për zbatimin e strategjisë, do të intensifikohet koordinimi ndërinstytucional dhe bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve vendore dhe ndërkombëtare, si dhe ofrimi i mbështetjes së nevojshme për viktimat. Ky proces do të përfshijë edhe perspektivën gjinore, me fokus në mbrojtjen e grave dhe vajzave nga viktimizimi. Strategjia do të bazohet në analizën e gjendjes aktuale të viktimave të krimit në Shqipëri dhe rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare si Komisioni Evropian, GREVIO, GRETA dhe CPT.

SNMVK lidhet me një sërë strategjish të tjera kombëtare si Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2021-2025, Strategjia kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025, dhe Plani i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave. Ajo përputhet gjithashtu me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030 dhe agjendën e integritetit evropian të Shqipërisë.

Ky dokument i ri strategjik është pjesë e angazhimeve të marra në Planin Kombëtar për Integritetin Evropian 2022-2024, në Kapitullin 23, ku theksi vihet tek përmirësimi i legjislacionit që rregullon të drejtat e viktimave dhe forcimi i pozitës së tyre në sistemin e drejtësisë penale.

Raporti 6-Mujor i Monitorimit për janar-qershor 2024, mbi zbatimin e SNMVK 2024-2030, është raporti i parë i monitorimit të zbatimit të SNMVK 2024-2030. Gjatë kësaj periudhe kanë nisur zbatimin 86 aktivitete dhe 33 masa nga institucionet përgjegjëse.

Plani i Veprimit 2024 - 2030, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Mbrojtjes së Viktimave të Krimit, konsiston në:

- ✓ 11 objektiva strategjike;
- ✓ 18 indikatorë nga Pasaporta e Indikatorëve;
- ✓ 48 masa;
- ✓ 203 aktivitete.

Me qëllim monitorimin lidhur me arritjet, progresin apo/dhe sfidat drejt përmbushjes së objektivave të strategjisë, nëpërmjet raportimit të pikave të kontaktit është siguruar informacioni nga çdo institucion përgjegjës lidhur me zbatimin e SNMVK-së. Ky raport është hartuar në kuadër të zbatimit të Planit të Veprimit 2024 – 2030 dhe mbulon progresin gjatë periudhës 1 janar – 30 qershor 2024.

Plani i Veprimit përbëhet nga 11 objektivat e mësipërme dhe përmban në total 48 masa dhe 203 aktivitete. Gjatë periudhës raportuese janë të zbatueshme 33 masa dhe 86 aktivitete. Vlerësimi i nivelit dhe statusit të zbatimit të masave të SND bazohet mbi informacionin e dhënë nga çdo njësi përgjegjëse për periudhën raportuese. Ministria e Drejtësisë ka kryer vlerësimin e informacionit gjatë muajit korrik 2024. Bazuar në një vlerësim të përgjithshëm të raportimit për periudhën janar – qershor 2024, rezultoni se niveli i zbatimit të masave të Planit të Veprimit është si më poshtë:

**QËLLIMI I I
POLITIKËS**

Fuqizimi i parandalimit dhe raportimit të krimit përmes informimit, ndërgjegjësimit dhe komunikimit efektiv me publikun dhe viktimave të krimit.



**QËLLIMI II I
POLITIKËS**

Një kuadër ligjor i përafëruar me standardet e parashikuara në direktivat e Bashkimit Evropian dhe aktet ndërkombëtare të tjera, institucione dhe profesionistë që ofrojnë mbështetje, mbrojtje efektive për viktimat e krimit dhe akses të drejtë të viktimës në një skemë kombëtare të kompensimit



**QËLLIMI III I
POLITIKËS**

Garantimi i të drejtës për informim, mbështetje dhe mbrojtje të viktimave në proceset penale dhe njohja e viktimave me nevoja mbrojtjeje të veçantë.



**QËLLIMI IV I
POLITIKËS**

Forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit mes aktorëve që veprojnë në fushën e mbrojtjes së viktimave të krimit në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.



Zbatueshmëria e SNMVK në nivel masash për janar-qershor 2024			
QP I	Plotësisht të zbatuara	Pjesërisht të zbatuara	Të pazbatuara
	3	2	1
QP II	Plotësisht të zbatuara	Pjesërisht të zbatuara	Të pazbatuara
	1	7	3
QP III	Plotësisht të zbatuara	Pjesërisht të zbatuara	Të pazbatuara
	3	4	2
QP IV	Plotësisht të zbatuara	Pjesërisht të zbatuara	Të pazbatuara
	3	2	2

II. METODOLOGJIA E MONITORIMIT

Metodologjia e Raportit të Monitorimit, përshkruan procesin e ndjekur gjatë hartimit të raportit dhe ka si qëllim kryesor të mundësojë udhëzimet e nevojshme për lehtësimin në kuptueshmërinë e tij, si dhe të orientohet drejt prezantimit të rezultateve kryesore për të nxjerrë në pah arritjet, sfidat dhe rekomandimet e adresuara për përmirësim.

Për të siguruar një proces monitorimi bazuar në arritje konkrete, Ministria e Drejtësisë realizon komunikime intensive me përfaqësuesit e strukturave të përfshira në Planin e Veprimit, me qëllim prezantimin e drejtë dhe të qartë të rezultateve dhe problematikave të hasura gjatë periudhës së raportimit.

Kështu, gjatë periudhës hartuese, është mbajtur një komunikim i vazhdueshëm (verbal dhe zyrtar) në varësi të specifikave për plotësimin e dokumentave raportues me disa prej institucioneve të përfshira në strategji, me qëllim evidentimin e rasteve të suksesit, të cilat kanë sjellë rezultate të dukshme në veprimtarinë e tyre, gjithashtu identifikimin e sfidave, problematikave dhe komponentëve të cilët kanë ndikuar apo penguar progresin apo zbatimin e aktiviteteve të parashikuara.

▪ **Koordinimi institucional për hartimin e Raportit të Monitorimit dhe Performancës**

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 128, dt. 08.11.2021 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Drejtësisë”, është ngritur Sektori i Monitorimit, Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistika ve, pranë Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë, e cila është struktura përgjegjëse për procesin monitorues si dhe hartimin e Raporteve të Monitorimit të Strategjive. Ky sektor kryen koordinimin me të gjitha institucionet përgjegjëse, si dhe më pas vijon me hartimin e raportit të monitorimit. Raporti i monitorimit të dokumentit strategjik (SNMVK 2024-2030) për periudhën 1 janar deri më 30 qershor 2024, është hartuar mbi bazën e kontributit të dhënë nga institucionet përgjegjëse dhe kontributore të planit të veprimit.

▪ **Periodiciteti i hartimit të Raportit të Monitorimit dhe Performancës**

Ministria e Drejtësisë, harton raporte gjashtëmujore dhe vjetore për monitorimin dhe raportimin e dokumenteve strategjike, të cilët prodhojnë informacion të nevojshëm dhe në kohë për politikëbërësit mbi progresin e zbatimit të masave që janë parashikuar në planin e veprimit të SNMVK-së për 7 vitet e ardhshme, raporte të cilat publikohen në linkun: www.drejtesia.gov.al/dokumenta-strategjik-mbrojtjes-se-viktimave-te-krimit-2024-2030

▪ **Manuali i Raportimit sipas sistemit IPSIS**

Ministria e Drejtësisë ka hartuar raportin e monitorimit dhe të performancës për periudhën përkatëse sipas manualit të hedhjes së të dhënave në sistemin IPSIS miratuar me vendimin nr.290, datë 11.4.2020 “Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (SIPI/IPSIS).

▪ **Përputhshmëria e raporteve të monitorimit dhe performancës me Parimet e Mirëqeverisjes**

Ky raport është hartuar përputhje me Parimet e Mirëqeverisjes të cilët përmbajnë një kornizë të vlerësimit të Raporteve të Monitorimit dhe të Performancës e cila mundëson analizën e rregullt të progresit të arritur

në zbatimin e Parimeve dhe caktimin e standardeve që duhet të përmbush vendi. Parimet janë të hartuara për vendet që duan të anëtarësohen në BE dhe që marrin ndihmë nga BE-ja përmes Instrumentit të Para-Anëtarësimit (IPA).

- **Efikasiteti:** Agregimi i niveleve të dokumenteve. Ky parim duhet të lejojë shfrytëzimin e sinergjive mes raporteve të dokumenteve të ndryshme. Nëse dokumentet janë të lidhura ngushtë në aspektin e përmbajtjes, atëherë sistemi i M & R-së duhet ta marrë këtë parasysh për të mundësuar zhvillimin e mëtejshëm të njëri-tjetrit dhe jo mbivendosjen e njëri-tjetrit. Elementet bazë të raporteve të M & R-së (p.sh. objektivat, masat, indikatorët) në dokumentin e nivelit më të ulët do të zhvillohen drejt përmbajtjes së M & R-së në dokumentet e nivelit në të lartë. Duhet të merren parasysh lidhjet. Ky parim duhet të përmirësojë frekuencën dhe përmbajtjen e raporteve të M & R-së.
- **Llogaridhënia:** Respektimi i përmbajtjes së dokumenteve të planifikimit. Raportet e monitorimit duhet të përqendrohen në elementet e dokumenteve të planifikimit për të siguruar llogaridhënie lidhur me reformat dhe ndërhyrjet e planifikuara.
- **Rëndësia:** Respektimi i nevojave të përdoruesve të monitorimit dhe performancës. Raportet e M & R-së duhet të jenë të përshtatura për nevojat e përdoruesit në aspektin e përmbajtjes, gjatësisë dhe frekuencës. Për më tepër, raportet duhet të japin llogari për arritjen e rezultateve në mënyrë të verifikueshme dhe në raport me treguesit SMART.

▪ **Mekanizimi i Integruar i Politikave**

Sipas Urdhërit Nr.90 datë 01.08.2023 të Kryeministrit “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe riorganizimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar” mekanizmat ndërsektorial tanimë funksionojnë mbi bazën e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës (GNP).

▪ **Fazat e ndjekura për hartimin e Raportit të Monitorimit dhe Performancës**

Fazat që janë ndjekur për përgatitjen dhe konsolidimin e raportimit të monitorimit dhe performancës, paraqiten si më poshtë:

- kërkesa për kontribut u dërgua në datë 11 korrik 2024 tek të gjitha institucionet raportuese në përputhje me standardet e sistemit IPSIS dhe Parimet e Mirëqeverisjes;
- publikimi në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Drejtësisë dhe dërgimi tek të gjitha institucionet e përfshira në strategji me qëllim marrjen e komenteve dhe sugjerimeve më datë 23 tetor 2024;
- konsolidimi i paketës pas marrjes dhe reflektimit të komenteve të sjella 31 tetor 2024;
- organizimi i mbledhjes me qëllim miratimi i raportit të monitorimit më datë 15 nëntor 2024;
- publikimi i Raportit 6 mujor të Monitorimit në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.

▪ **Metodologjia e analizimit të të dhënave për Raportin e Monitorimit dhe Performancës**

Raporti shpreh qartë vlerësimin e arritjeve kryesore duke përdorur grafikë, dashboards, analiza të thelluara, edhe vizualisht përmes tabelave. Gjithashtu paraqitet qartë identifikimi i shkallës së performancës për Qëllimet e Politikave dhe Objektivët Specifikë.

Analiza mbi progresin e realizimit të Qëllimeve Politike ndjek një qasje të strukturuar. Progresi lidhur me secilin Qëllim Politik është analizuar në përgjithësi sipas Objektivave Specifikë (OS) përkatës. Në vijim, për secilin OS është paraqitur një përmbledhje e rezultateve sasiore dhe cilësore të zbatimit të masave përkundrejt kryerjes së veprimeve për realizimin e tyre nga institucionet përgjegjëse, analiza e risqeve dhe veprimeve për adresimin e tyre (sipas rastit) dhe analiza e treguesve të performancës, nëse kjo ka qënë e mundur mbi bazën e të dhënave të paraqitura nga institucionet përgjegjëse.

Prezantimi i rezultateve mbi zbatimin a masave ndjek numërimin e Planit të Veprimit dhe është paraqitur me sfond me ngjyrë sipas nivelit të zbatimit (*të zbatuara plotësisht/ të zbatuara pjesërisht/ të pazbatuara*). Disa masa rezultojnë të pazbatueshme dhe janë paraqitur me sfond të bardhë. Ato përfshijnë: (i) masat afati i zbatimit i të cilave fillon pas periudhës aktuale të raportimit; (ii) masa të cilat nuk mund të zbatohen nga institucioni raportues për arsye të cilat nuk varen nga institucioni (p.sh. mungesë e kompetencave).

➤ **Përcaktimi i nivelit të zbatimit të masave** (në përqindje) është ai i raportuar nga secili institucion përgjegjës, dhe është evidentuar në kontributet e përcjella prej tyre mbi çdo masë të përcaktuar. Shkalla e zbatimit të masave është përcaktuar si më poshtë:

- **E zbatuar**: masa e cila është përmbushur plotësisht;
- **Pjesërisht e zbatuar/Në proces**: masa e cila në periudhën e raportimit ka pasur zbatim të pjesshëm dhe/apo që vijon të jetë në zbatueshmëri.
- **E pazbatuar**: masa e cila nuk ka pasur zhvillim dhe progres për periudhën raportuese.

➤ **Përcaktimi i nivelit të realizimit të OS** është kryer përkundrejt numrit të masave të zbatuara (i shprehur në %). Përlllogaritja është kryer në bazë të raportit të masave të zbatuara dhe numrit total të masave të zbatueshme për një objektiv specifik.

➤ **Përcaktimi i nivelit të realizimit të Qëllimeve të Politikave** është përlllogaritur si mesatarja e përqindjes së realizimit të Objektivave Specifikë përkatës.

▪ **Konsultimi publik i Raportit të Monitorimit dhe Performancës**

Një komponent i rëndësishëm i mirëqeverisjes që ndërlidhet me rritjen e cilësisë së llogaridhënies dhe transparencës së institucioneve publike si dhe forcimin e demokracisë është procesi i konsultimit publik. Tashmë korniza rregullatore për konsultimin publik është unifikuar dhe ka ndikuar në përmirësimin e transparencës dhe cilësisë së politikave. Prioritare mbetet përfshirja aktive e publikut dhe shoqërisë civile në proceset e politikëbërjes.


Në përputhje me kriteret ligjore për konsultimin publik, pas hartimit të draft raportit, Ministria e Drejtësisë e dërgoi në datën 23.10.2024 dokumentin për konsultim pranë institucioneve raportuese dhe organizatave të shoqërisë civile, si dhe e publikoi draftin në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, ku caktohet dhe një adresë elektronike për marrjen e komenteve, në faqen e internetit www.drejtesia.gov.al, në menu prioritet/strategjia ndërsektoriale/Strategjia Ndërsektoriale e Mbrojtjes së Viktimave të Krimit. Në përfundim të procesit konsultues, Ministria e Drejtësisë kryen reflektimin e komenteve/sugjerimeve relevante mbi draft raportin e monitorimit dhe vijoi me zhvillimin e një takimi të dedikuar, në kuadër të diskutimit të analizës së kryer, gjetjeve të raportit, vlerësimit të qëllimeve të politikës në prezencë të të gjithë institucioneve zbatuese dhe raportuese të planit të veprimit.

Pas miratimit të raportit në Komitet Drejtues Sektorial, Ministria e Drejtësisë publikon në faqen e tij zyrtare raportin në gjuhën Shqipe.

III. PROGRESI I ZBATIMIT SIPAS QËLLIMEVE

I. Qëllimi i Parë i Politikës

Fuqizimi i parandalimit dhe raportimit të krimit përmes informimit, ndërgjegjësimit dhe komunikimit efektiv me publikun dhe viktimave të krimit.



Arritjet kryesore:

- **Ministria e Drejtësisë**, në rolin e ministrisë përgjegjëse për hartimin dhe monitorimin e politika ve strategjike në fushën e drejtësisë, për herë të parë ka hartuar Strategjinë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024 – 2030, miratuar në dhjetor 2023 me Vendim të Këshillit të Ministrave.
- **Ministria e Drejtësisë**, në kuadër të kësaj strategjie ka nisur për herë të parë javën sensibilizuese nga 15-22 Shkurt 2024, në kuadër të mbrojtjes së viktimave të krimit, e cila do të jetë e përvitshme. Kjo fushatë synon informimin e publikut mbi të drejtat, mbrojtjen dhe aksesimin e shërbimeve për viktimat e krimit dhe fton të gjithë profesionistët, ekspertët e botës akademike, shoqërinë civile, bizneset, OJF-të, mediat, grupet e viktimave si dhe organizatat që i përfaqësojnë ato, të bashkëpunojnë për të mundur drejtësi për çdo viktimitë.
- Në bashkëpunim të ngushtë me shoqërinë civile, **Ministria e Drejtësisë** ka realizuar një sër aktivitetesh:
 - Lancimin e fushatës nga Ministri i Drejtësisë më datë 6 shkurt 2024, me anë të një videomesazhi, nëpërmjet së cilës theksoi rëndësinë e kësaj fushate dhe ftoi të merrnin


- pjesë institucionet në nivel qendror dhe vendor, bizneset, media dhe shoqërinë civile për t'u bashkuar si një zë i fuqishëm në mbrojtje të viktimave të krimit.
- Më 16 shkurt 2024, Ministria e Drejtësisë në koordinim me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë së Tiranës organizoi një takim ndërinstytucional, i cili synonte të forconte bashkëpunimin mes sektorit privat, institucioneve shtetërore dhe organizatave jofitimprurëse, duke u fokusuar në mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave të krimit.
 - Më datë 17 shkurt 2024, në Lezhë u zhvillua aktiviteti i rradhës, duke përfshirë njësr aktivitetesh gjithëpërfshirëse mbi ndërgjegjësimin dhe informimin e publikut në mbrojtje të viktimave të krimit, si vijon:
 - Inagurimi dhe promovimi i pikturës murale #nëmbrojtjetëviktimavetëkrimit, të realizuar me përfshirjen e të rinjve lezhianë, që do të përcjellë mesazhet e përbashkëta të solidaritetit, përkushtimit të të rinjve ndaj mbrojtjes së të drejtave dhe sigurisë së viktimave të krimit.
 - Performancë në Teatrin social lëvizës “Drejtësia është miqësore me ty - Ti nuk je Vetëm!”, e cila shfaq një rrëfim të fuqishëm dhe të ndjeshëm mbi sfidat dhe vështirësitë e të miturve në konflikt/kontakt me ligjin që janë viktimat e shpeshta të krimit.
 - Stenda informuese të Zyrës për Ndihmën Ligjore Falas, të vendosura në sheshin kryesor të qytetit të Lezhës, në dispozicion të qytetarëve si një burim i rëndësishëm i informimit me bazë të gjerë, mbi të drejtat ligjore dhe shërbimet e disponueshme për mbrojtjen e viktimave të krimit.
 - Më datë 19 shkurt 2024, u zhvillua Leksion i hapur dhe prezantimi i Strategjisë Ndërsektoriale të Mbrojtjes së Viktimave të Krimit, me studentët e Universitetit të Elbasanit (TBC) (MD+DNJF), ku studentët e këtij universiteti u informuan edhe në lidhje me shërbimet e drejtorisë së ndihmës juridike falas.
 - Më datë 21 shkurt 2024, përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, morën pjesë në konferencën ku u prezantuan gjetjet e Studimit Kombëtar të realizuar nga organizata Together for Life me mbështetjen e Ambasadës së Vendeve të Ulta në kuadër të projektit “Girls and Women Empowerment Synergy”.
 - Më datë 21 shkurt 2024 përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë morën pjesë me ftesë të Kryetarit të Bashkisë Shkodër lidhur me Tryezen Vendore të Bashkëpunimit Ndërinstytucional për Drejtësinë për të Mitur, takim i cili kryhet në kuadër edhe të Javës Ndërgjegjësuere për Viktimat e Krimit.
 - Më datë 23 shkurt 2024, Ministri i Drejtësisë, së bashku stafin e MD, zhvilloi takimin në qendrën “Vatra” në Vlorë. Tryezë diskutimi me aktorët lokal pranë zyrave të Ndihmës Juridike në Vlorë (Në bashkëpunimin me qendrën “Vatra”, Bashkinë Vlorë, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, etj).
- **Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**, në kuadër të shtrirjes së aksesit të sistemeve/platformave online të informimit dhe raportimit të krimit, ka ngritur dy linja Kombëtare të Këshillimit, atë për Gratë dhe Vajzat (LKGV), viktimat të formave të ndryshme të dhunës 116-117, si dhe për fëmijët, viktimat të formave të ndryshme të abuzimit ALO 116-111, të cilat ofrojnë shërbime këshilluese përmes komunikimit me telefon, si edhe referim në institucionet përgjegjëse të rasteve të dhunës, apo çështje specifike që lidhen me nevojat të veçanta që mund të kenë gratë, vajzat dhe fëmijët.
Për vitin 2024 janë trajtuar 2,272 telefonata nga Linja Kombëtare të Këshillimit për Gratë dhe Vajzat ALO 116-117. Për gjashtëmuorin e parë 2024, Linja e Këshillimit për Fëmijë ALO 116-111 ka trajtuar këto raste:
Total telefonatash: 10,066 (Total rastesh: 181; Total referime: 142; Total këshillim: 594; Cyberbullyng: 21).
 - Linja Kombëtare të Këshillimit, për Gratë dhe Vajzat ALO 116-117 përgjatë periudhës Janar – Qershor 2024, ka prodhuar:
 - 4 video ndërgjegjësuere me tema të ndryshme si dhuna digjitale, dhuna në familje dhe me bazë

- gjinore si dhe përdorimi i gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit duke targetuar publikun e gjerë;
- 1 dokumentar me fokus rrugëtimin e dy të mbijetuarave të dhunës në familje si dhe punën e Mekanizmave të Koordinuar të Referimit për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore;
 - 5000 kopje fletëpalosje ndërgjegjësuese me tema të ndryshme si dhuna digjitale, dhuna në familje dhe me bazë gjinore, gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit.
 - 4 radio spote me tema të ndryshme si dhuna digjitale, dhuna në familje dhe me bazë gjinore, gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit të transmetuara 600 herë të dëguara nga 180,000 dëgjues në mbarë vendin.
- **Ministria e Brendshme** ka në dispozicion linjat kombëtare për viktimat e trafikimit në Shqipëri. Një punonjës i stafit të Sektorit të Antitrafikut, disponon dhe pret vetëm thirrjet hyrëse. Me qëllim promovimin e Linjës dhe ndërgjegjësimin e komunitetit ndaj fenomenit të trafikimit, më datë 23 janar 2024, u prezantua fushata e komunikimit antitrafik “E vërteta N’Ndrit” 116 006, si pjesë e programit “Transformimi i përgjigjes kombëtare ndaj trafikimit të qenieve njerëzore në dhe nga Shqipëria”, i cili financohet nga qeveria e Mbretërisë së Bashkuar dhe zbatohet nga UNICEF në Shqipëri. Qëllimi kryesor i kësaj fushate është reduktimi i trafikimit të qenieve njerëzore brenda dhe nga Shqipëria nëpërmjet parandalimit të dukurisë, mbrojtjes dhe shërbimeve për riintegrimin e të mbijetuarve, si dhe fuqizimin e partneriteteve të koordinuara antitrafik. UNICEF ka përgatitur fushatën e komunikimit të Programit Antitrafik, në konsultim të ngushtë me Ministrinë e Brendshme, Ambasadën Britanike në Tiranë dhe me partnerët zbatues të programit.
 - **Avokati i Popullit** ka pasur një rol aktiv në promovimin e të drejtave të fëmijëve duke organizuar 9 aktivitete në institucione arsimore parauniversitare. Këto aktivitete janë përqendruar në rritjen e njohurive të nxënësve, prindërve dhe stafit pedagogjik për të drejtat e fëmijëve dhe rolin e Avokatit të Popullit në mbrojtjen e tyre, duke përfshirë rëndësinë e përdorimit të sigurt të internetit dhe mbrojtjen nga dhuna online. Po ashtu, janë dëgjuar shqetësimet e fëmijëve për çështje që i preokupojnë ata.
 - Gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2024, **KMD** ka bashkëpunuar me median si burim i mundshëm informacioni, për informimi e viktimave të krimit për të drejtat, mbrojtjen dhe aksesimin e shërbimeve. KMD ka zhvilluar 17 dalje në media në adresimin e shkaqeve të diskriminimit dhe promovimit e barazisë, si dhe kanë marrë pjesë në aktivitete të ndryshme si takime, seminare, trajnime, tryeza diskutimi, grupe pune, workshop, në kuadër të forcimit të bashkëpunimit me institucione shtetërore apo organizata, kombëtare apo ndërkombëtare, që mbrojnë të drejtat e njeriut.
 - **Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Falas**, si dhe nga stafi i Drejtorisë zhvillojnë në mënyre periodike fushata informuese për viktimat e krimit. 81 aktivitete ndërgjegjësuese, informuese të zhvilluara gjatë periudhës Janar- Qershor 2024.
 - Në rrjetet sociale të **MSHMS** dhe të të gjitha institucioneve pjesëmarrëse, përfshirë organizatën e shoqërisë civile që ofron shërbimin "Helpline", është publikuar fushata "16 ditët e aktivizimit kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave".
 - **MAS** ka realizuar në zonat urbane dhe rurale tema informuese dhe ndërgjegjësuese me nxënës, prindër komunitet nga SHPS, oficerët e sigurisë për luftën kundër krimit, për të parandaluar dhunën, si dhe kundër shfrytëzimit, trafikimit dhe të gjitha formave të dhunës dhe torturimit të fëmijëve.. Këto takime informuese janë realizuar në shkollat me nxënës të arsimit 9-vjeçar dhe të mesëm.

- **MSHRF** ka realizuar më 19 qershor 2024 sesionin informues me temë; “Trafikimi i Paligjshëm-info sesion për të arritur qëllimin e një shoqërie pa trafikim njerëzor” në bashkëpunim me AKR dhe Fondacioni Mary Ward Loreto.
- **DPPSH** raporton se pranë çdo drejtorie vendore të policisë (me përjashtim të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë e cila ka 3 njësi në përdorim), janë krijuar Njësitë Miqësore të Intervistimit me të Mitur. Përshtatja e ambienteve dhe pajisjet e përdorura në këto njësi intervistimi kanë qënë konform standardeve teknike të përcaktuara në procedurat standarde të veprimit për “Njësinë e Intervistimit të të Miturve, standardet teknike dhe procedurat e përdorimit të këtyre ambienteve”. Përdorimi i këtyre njësive është i detyrueshëm, kryesisht për intervistimit e të miturve viktimat të krimeve seksuale, të cilat realizohen me regjistrime me video dhe audio.
- Në lidhje me komunikimin efektiv me viktimat e krimit, bazuar në nevojat specifike të tyre, **DPPSH** ka miratuar urdhërin gjatës periudhës janar-qershor 2024, “ Për respektimin dhe garantimin e të drejtës për personat e shoqëruar për t’u informuar mbi të drejtat ligjore që kanë, në ambientet e PSH”, i cili ka mundësuar krijimin e Letrave të të Drejtave për kategoritë: a) Të mitur autorë, viktimat dhe në konflikt me ligjin b) persona të shoqëruar madhorë dhe të mitur në konflikt me ligjin; c) viktimat të dhunës në familje. Letrat e të Drejtave për kategorinë e përmendur më sipër janë përkthyer në 9 gjuhë të botës: anglisht, italisht, frengjisht, rusisht, serbokroatisht, gjermanisht, arabisht, polonisht, greqisht.

II. Qëllimi i Dytë i Politikës

Një kuadër ligjor i përafër me standardet e parashikuara në direktivat e Bashkimit Evropian dhe aktet ndërkombëtare të tjera, institucione dhe profesionistë që ofrojnë mbështetje, mbrojtje efektive për viktimat e krimit dhe akses të drejtë të viktimës në një skemë kombëtare të kompensimit



Arritjet kryesore:


- Në muajin Mars 2024, **INSTAT** mori pjesë në takimin vjetor, i organizuar online nga Eurostat lidhur me statistikat e krimeve dhe drejtësisë penale. Gjatë takimit, një nga pikat e diskutuara lidhej me pëmirësimin e standarteve dhe mundësive të krahasimit të statistikave të veprave penale dhe viktimave të krimit. Arritja e standartizimit të statistikave nga institucione të ndryshme dhe krahasueshmëria e statistikave do të sigurohet me zbatimin e Klasifikimit Ndërkombëtar të Statistikave të Krimit për qëllime Statistike (ICCS).
- Në kuadër të forcimit të kapaciteteve të profesionistëve, **UP** ka zhvilluar trajnimin e asistuesve a) 8 psikologëve asistues; b) 10 psikologëve asistues dhe vlerësues dhe c) 6 psikologëve vlerësues për tematika dhe çështje të viktimave.
- Akademia e Sigurisë ofron programe për formimin, specializimin, kualifikimin dhe trajnimin, në të gjitha nivelet të punonjësve në uniformë e civilë të Policisë së Shtetit dhe institucioneve të tjera, që operojnë në fushën e rendit dhe sigurisë publike.
Akademia e Sigurisë përbëhet nga dy njësi kryesore:
Kolegji Profesional i Formimit Policor, është përgjegjës për shkollimin, trajnimin dhe specializimin e punonjësve të nivelit zbatues. Gjithashtu, zhvillon trajnime, specializime, dhe ecurinë në karrierë për nivelin zbatues.
- Në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit, mbështetur në Programin e Studimeve “Bachelor”, miratuar me vendim nr.52. datë 08.10.2021 të Senatit Akademik, të AS-së zhvillohen tema të mbrojtjes së viktimave të krimit në lëndët e mëposhtme:
 - “Barazia dhe Ligji”,
 - “Psikologjia Ligjore”.
 - “Teknikat dhe Taktikat e pyetjes”,
 - “Hetimi i krimeve kundër personit dhe pronës”,
 - “E drejta penale”,
 - “Të Drejtat e Njeriut”,
 - “E drejta procedurave penale”.

Gjithashtu, në nivelin Master për “Sigurinë dhe Hetimin”, në programin mësimor është përfshirë lënda “Kriminologji”.

- Departamenti i Formimit të Vazhdueshëm, ofron trajnime të tjera të “Mbrojtjes së viktimave të krimit” për trajnimet vazhduese të punonjësve të Policisë së Shtetit, mbi bazën e një plani vjetor trajnimesh të miratuar.
Akademia e Sigurisë përmban një kurrikulë ekzistuese për çështjet e mbrojtjes së viktimave të krimit, gjithëpërfshirëse në temat që ajo trajton dhe në përputhje me zhvillimet ndërkombëtare.
 - Kuadri ligjor që i referohet kurrikulave përfshin aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar, legjislacion shqiptar, me ndryshimet përkatëse, jurispruencën e gjykatave ndërkombëtare dhe ato vendase, si dhe përdorimin e manualeve të ndryshme, të cilat vijnë në mbështetje të akteve të mësipërme për një qasje sa më të gjerë.Gjithashtu që problematikat dhe trajtimi i tyre të bëhet më gjithëpërfshirës nga struktura të tjera jashtë Policisë së Shtetit, për studentët/kursantët afrohen leksione të hapura me ekspertë e profesionist nga organizata të tjera joqeveritare apo organizma të sistemit gjyqësor dhe procedural.
Në aktet e brendshme të Akademisë së Sigurisë, përcaktohet para çdo fillim viti akademik, të bëhet rishikimi dhe përditësimi i kurrikulave mësimore.

III. Qëllimi i Tretë i Politikës

Garantimi i të drejtës për informim, mbështetje dhe mbrojtje të viktimave në proceset penale dhe njohja e viktimave me nevoja mbrojtjeje të veçantë.



Arritjet kryesore:


- **DPPSH** ka miratuar urdhërin “Për respektimin dhe garantimin e të drejtës për personat e shoqëruar për t’u informuar mbi të drejtat ligjore që kanë, në ambientet e PSH”, me një gjuhë dhe format miqësor për kategoritë e veçantë të viktimave.
- **DPPSH** në bashkëpunim me Unicef ka trajnuar 170 punonjës policie për temën: "Teknikat Shkencore të Intervistimit me të mitur", për të cilën është përpunuar dhe përgatitur një Manual nga Unicef dhe është shpërndarë në rrugë elektronike tek të gjithë specialistët e hetimit të krimit të trajnuar për këtë temë.
- Në kuadër të përmirësimit të komunikimit dhe ndërgjegjësimit publik, është përgatitur një uebsajt i ri nga **DHKN**, ku qytetarët janë informuar për shërbimet dhe aktivitetet e saj. Përveç kësaj, janë prodhuar dhe shpërndarë video informuese, fletëpalosje dhe broshura në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Informacionet janë pasqyruar gjithashtu në rrjete sociale për të arritur një audiencë më të gjerë. Është organizuar gjithashtu një trajnim dhe specializim për ndërmjetësit që do të ndërmjetësojnë raste ku janë përfshirë viktima të krimit, duke u bazuar në standardet më të mira ndërkombëtare. Janë mbajtur workshop-e të veçanta me përfaqësues nga Ndërmjetësimi dhe Prokuroria e Vlorës, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, dhe Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, për të përmirësuar bashkëpunimin dhe efektivitetin në trajtimin e rasteve.

- **Shkolla e Magjistraturës** ka zhvilluar trajnimin me temë "Viktima si subjekt i procesit penal", ku kanë marrë pjesë 4 prokurorë dhe 5 oficerë të policisë gjyqësore.
- **Terre des Homme** ka organizuar një trajnim mbi teknikat e intervistimit miqësor të fëmijëve viktima të abuzimit fizik dhe seksual, zhvilluar në Tiranë, Vlorë dhe Shkodër me pjesëmarrjen e 27 prokurorëve, 24 oficerëve të policisë gjyqësore dhe 12 koordinatorëve të viktimave.
- **PP** raporton se koordinatorët e viktimave, janë një mbështetje për viktimat për marrjen e informacionit lidhur me procesin, shërbimet, të drejtat e tyre dhe jo vetëm, duke komunikuar në një gjuhë të thjeshtë dhe të miqësore për ta.
- **Ministria e Brendshme** me datë 6-7 shkurt 2024, tridhjetë përfaqësues nga institucionet shtetërore dhe organizatat e shoqërisë civile u angazhuan në hakathonin e parë kundër trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri. Veprimtaria u organizua nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri në bashkëpunim me Zyrën e Përfaqësuesit Special të OSBE-së dhe Ministrinë e Brendshme. Qëllimi i hackathon-it ishte rritja e ndërgjegjësimit për mënyrat se si keqpërdoret teknologjia në Shqipëri për të shfrytëzuar viktimat, veçanërisht fëmijët. Ai synonte gjithashtu të identifikonte platformat dhe faqet e internetit që janë veçanërisht të ekspozuara ndaj rreziqeve të trafikimit të qenieve njerëzore dhe të ofronte një pasqyrë se si trafikantët i shfrytëzojnë ato. Përveç kësaj, hackathon shërbeu për të ndërtuar një rrjet ekspertize për të adresuar trafikimin e njerëzve të lehtësuar nga teknologjia, duke përdorur një metodologji "të mësuarit duke bërë", duke i dhënë përparësi procesit të të mësuarit mbi teorinë dhe duke testuar njohuritë dhe kapacitetet e pjesëmarrësve në një mjedis të drejtpërdrejtë online, për të zbuluar faqet e internetit dhe platformat e mediave sociale që rekrutojnë viktimat për shfrytëzim seksual.
- Më datë 26.04.2024, në Ministrinë e Brendshme u zhvillua takimi me anëtarët e Bordit Këshillimor për viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit. Takimi u zhvillua në kuadër të zgjerimit të Bordit Këshillimor. Në takim morën pjesë 6 anëtarë të Bordit, të shoqëruar nga përfaqësues të Koalicionit Kombëtar Antitrafik (KKSAT). Gjatë takimit u diskutua rreth rëndësisë që ka Bordi Këshillimor, roli që luan në përmirësimin e politikave në luftën kundër trafikimit të personave, si dhe në rritjen e përfaqësimit të viktimave të trafikimit në të gjitha fazat e vendimmarrjes, hartimit të politikave dhe programeve për parandalimin e trafikimit dhe mbrojtjen e viktimave, si dhe në rritjen e partneritetit të institucioneve shtetërore me shoqërinë civile në ndërgjegjësimin, parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të personave.
- **Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale** vijon takimet me rrjetin e koordinatorëve vendorë për referimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, me synim forcimin e kapaciteteve të Koordinatorëve Vendorë të Dhunës në Familje në trajtimin e rasteve viktima të dhunës si dhe të lehtësojë shkëmbimin e eksperiencave, ndarjen e praktikave të mira dhe sfidave të hasura duke promovuar një qasje të koordinuar dhe gjithëpërfshirëse në mbështetjen e viktimave dhe në parandalimin e dhunës. Gjithashtu, Ministria ka dhënë kontribut në lidhje me zgjerimin e shërbimeve për viktimat në të gjithë territorin e vendit duke mbështetur financiarisht ngritjen dhe funksionimin e shërbimeve nëpërmjet Fondit Social, për viktimat e dhunës në familje dhe viktimat e trafikimit, si dhe për trajtimin e fëmijëve viktima të abuzimit seksual dhe formave të tjera të abuzimit- trajtuar, përfshirë edhe 2 linja këshillimi falas.
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale bashkë me përfaqësues të tre qendrave të menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale si dhe mekanizmat përkatës të referimit ka zhvilluar një trajnim për të ndarë praktikatat më të mira dhe sfidat e hasura në adresimin e nevojave të viktimave.

- **Prokurori i Përgjithshëm** miratoi udhëzimin "Për hetimin dhe ndjkejen penale efektive të veprave penale kundër trafikimit të personave", ku u përcaktua edhe detyrueshmëria e rritjes së kapaciteteve nëpërmjet trajnimeve për vlerësimin dhe identifikimin e viktimave të krimit (viktimave të mundshme të trafikimit; viktimat e shfrytëzimit për prostitucion; viktimat e dhunës seksuale).
- Gjatë vitit 2024, **Ndihma juridike falas** ka shtrirë shërbimin e saj në të gjitha territorin e vendit në gati 20 Qendra. Gjithashtu, viktimat e krimit e përfitojnë ndihmën juridike falas edhe në Ojft të cilat janë më të specializuara në trajtimin (psiko-social) të viktimës; Qendra "Psiko Sociale Vatra" dhe "Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza". Për periudhën Janar- Qershor 2024 kanë përfituar ndihmë juridike parësore 717 persona (638 viktima të dhunës në familje, 17 viktima të abuzuar seksualisht, 59 viktima të trafikimit të qenieve njerëzore dhe 3 viktima të mitur). Përsa i përket ndihmës juridike dytësore, kanë përfituar ndihmë juridike 60 persona, viktima të dhunës në familje.
- **Shkolla Shqiptare e Administates Publike** në bashkëpunim me DNJF ka zhvilluar trajnime për ofruesit e ndihmës juridike parësore, specialistëve pranë Qendrave të Shërbimit të Ndihmës në lidhje me legjislacionin specifik për viktimat e krimit.
- **KDIMDHP** ka zhvilluar një sesion trajnues lidhur me legjislacionin e mbrojtjes së të dhënave personale, parimeve dhe kritereve mbi të cilat zhvillohet ky proces, mbi problematikat që krijohen në këtë fushë me zhvillimin e teknologjisë dhe digjitalizimin e shërbimeve, si dhe njohjen me raste konkrete. Zyra e Komisionerit ndërmori iniciativën e hartimit të Modullit Trajnues "Mbi mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësinë gjatë lundrimit në internet". Ky dokument mbi mënyrën e përdorimit të rrjeteve sociale, kujdesin që duhet treguar për mbrojtjen e privatësisë, rëndësinë e sigurisë online dhe mbrojtjen e të dhënave personale nga rreziqet që ndeshin në internet.
- **AMA** ka rishikuar Kodin e Ri të Transmentimit, e cila përfshin një sërë dispozitash për garantimin e të drejtave ndaj viktimave të krimit. Ky Kod mbron të drejtën për privatësi dhe mbron të dhënat personale duke parashikuar dispozita në respektimin e të drejtave të fëmijëve viktima të krimit, përfshirë viktimat e krimit në familje, kur raportojnë rastet në të cilat fëmijët janë viktima ose autorë të bullizmit, dhunës seksuale dhe veprave penale të tjera penale. Gjithashtu, parashikon standarde të detajuara për adresimin e problemeve të fëmijëve dhe mënyrën e trajtimit të fëmijëve - viktima të dhunës, abuzimit fizik, psikologjik, seksual, trafikimit, me synim mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve gjatë transmetimeve audio dhe audiovizive, duke shmangur intervistimin e fëmijëve pasi ndalohe shpërndarja e çdo të dhëne që çon drejtpërdrejtë ose në mënyrë të tërthortë në identifikimin me pamje dhe zë i fëmijës viktimë.

IV. Qëllimi i Katërt i Politikës .

Forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit mes aktorëve që veprojnë në fushën e mbrojtjes së viktimave të krimit në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.



Arritjet kryesore:

- Gjatë periudhës Janar - Qershor 2024, **Mekanizmi i Koordinuar i Referimit (MKR)** të Bashkisë Tiranë ka arritur të trajtojë 520 raste të dhunës me bazë gjinore dhe në familje; të përditësojë Sistemin REVALB me 195 raste të dhunës në familje; të organizojë 11 mbledhje të Ekipit Teknik Ndërdisciplinar në total për trajtimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në familje, ndër të cilat 6 janë mbledhje të Ekipit Teknik Ndërdisciplinar dhe 5 mbledhje të Ekipit Teknik Ndërdisciplinar bërthamë.
- **Ministria e Drejtësisë** më 16 shkurt 2024 në koordinim me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë së Tiranës organizoi një takim ndërinstitucional, i cili synonte të forconte bashkëpunimin mes sektorit privat, institucioneve shtetërore dhe organizatave jofitimprurëse, duke u fokusuar në mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave të krimit.
- **Bashkia Tiranë** ka marrë pjesë edhe në konsultime të përbashkëta për trajtimin e rasteve sipas të gjitha të drejtave, ku viktimat e krimit janë grupe të tjera vulnerabël, si të moshuarit, personat që i përkasin komunitetit LGBTI+ etj.
- Bashkia Tiranë ka organizuar trajnime dhe takime në kuadër të ngritjes së kapaciteteve për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje.
- AP ka trajtuar gjatë kësaj periudhe 10 raste për dhunën ndaj të miturve dhe ka adresuar “Rekomandimin me objekt garantimin e mbrojtjes së fëmijës me aftësi të kufizuara, në interesin

më të lartë të tij, drejtuar institucioneve vendore të administratës publike”. Për periudhën Janar-Qershor 2024 është kryer 1 raportim për nivelin e zbatimit të rekomandimeve të AP.

- **Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi** ka dhënë rekomandimet e tij në mbrojtje të të drejtave të njeriut të cilat rezultojnë se pjesa më e madhe e tyre janë marrë në konsideratë nga institucioni përgjegjës.
- **Avokati i Popullit**, ka ngritur Observatorin për Femicidet në Shqipëri, gjatë periudhës raportuese, në një event me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucioneve të drejtësisë, të ministrive përgjegjëse për çështjet e dhunës në familje, policisë, OJF dhe organizata ndërkombëtare. Observatori për Femicidet është një mekanizëm monitorimi lidhur me vrasjet e grave/vajzave, me qëllim parandalimin e këtij fenomeni dhe fuqizimit të mekanizmit për mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave të dhunës gra/vajza.
- Është përcaktuar metodologjia për mbledhjen e të dhënave, që bazohet në kuadrin statistikor të OKBsë. Nëpërmjet **Observatorit për Femicidet** po mblidhen të dhënat në nivel kombëtar, të cilat po i nënshtrohen një analize të thellë, që do të shërbejë për identifikimin e boshllëqeve në zinxhirin e mekanizmit mbrojtës për viktimat e dhunës, si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e situatës së dhunës ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri, nëpërmjet përgatitjes dhe publikimit të raporteve vjetore.
- **Avokati i Popullit** gjatë këtij procesi do të udhëhiqet nga parimi i ruajtjes së konfidencialitetit, mbrojtjes së të dhënave personale dhe të dhënave sensitive, bazuar në legjislacionin në fuqi. Sipas metodologjisë të dhënat po mblidhen për vrasjet e grave/vajzave për periudhën 2020- 2023. Të dhënat mblidhen dhe analizohen bazuar në informacionet e sjella nga Policia, prokuroritë, monitorimi i seancave gjyqësore, nga shërbimet sociale pranë bashkive, monitorimi i mediave.

IV. KONKLUZIONE

Strategjia Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit ka kaluar në 6-mujorin e parë të zbatimit të saj dhe pavarësisht fazës së hershme të strategjisë, vihet re vëmendja e shtuar e institucioneve rreth masave drejtuar forcimit të figurës së viktimave të krimit, mbështetjes dhe mbrojtjes së tyre.

Në kuadër të SNMVK-së, janë parashikuar masa konkrete për përafrimin e legjislacioni shqiptar me direktivat e BE-së dhe me rekomandimet e mekanizmeve monitorues të konventave ku shteti shqiptar është palë. Vazhdimi i zbatimit të këtyre masave plotësisht në fazat e tjera të zbatimit të strategjisë do të sigurojë një mbështetje të fortë ligjore për viktimat e krimit sidomos ato me nevoja të veçanta mbrojtjeje.

Gjatë kryerjes së procesit të monitorimit janë evidentuar disa problematika që vlerësohen se kanë ndikuar në nivelin e zbatueshmërisë së Planit të Veprimit. Gjatë kësaj periudhe, zbatimi dhe monitorimi, si dy procese të ndërlidhura që kanë orientuar Ministrinë e Drejtësisë drejt reflektimit dhe konkluzioneve, mund të përmendim ndër më kryesoret:

- ✚ Mbetet problematike përgjegjshmëria e institucioneve për të raportuar në kohë dhe me cilësi lidhur me informacionin mbi masat e Planit të Veprimit. Nevojitet një bashkëpunim më i lartë i institucioneve përgjegjëse, për të kontribuar dhe raportuar lidhur me implementimin e Planit të Veprimit 2024-2030, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit.
- ✚ Mosdërgimi i informacionit mbi disbursimin financiar për aktivitetet e parashikuara në Planin e Veprimit, ndikon në pasqyrimin jo real të kostove për zbatimin e Strategjisë.
- Institucionet kanë raportuar se hasin vështirësi në raportim lidhur me:
 - buxhetin e shpenzuar për realizimin e aktiviteteve të mbuluara nga donatorët (informacion i cili nuk disponohet nga të gjitha pikat e kontaktit pranë institucioneve raportuese);
 - buxhetin e shpenzuar për realizimin e aktiviteteve të mbuluara nga buxheti i shtetit .

V. SFIDAT

Me qëllim përmirësimin e zbatimit dhe rritjes së impaktit të Planit të Veprimit 2024 – 2030, sfidat e rëndësishme për periudhat vijuese të monitorimit janë:

- ✚ Sigurimi i një procesi gjithëpërfshirës dhe transparent konsultimi gjatë fazave të raportimit, monitorimit me institucionet përgjegjëse dhe grupet e interesit.
- ✚ Sfidë mbetet dhe dokumenti i Pasaportës së Treguesve të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë, pasi institucionet duhet të raportojnë mbi 18 treguesit e SNMVK-së për raportin e ardhshëm.
- ✚ Rritja e nivelit të përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies nga strukturat e brendshme të institucioneve përgjegjëse edhe nëpërmjet fuqizimit të koordinimit ndërinstitutional.
- ✚ Kryerja e procesit të monitorimit periodik, diskutimit të gjetjeve dhe miratimit të raporteve respektive sipas afateve të përcaktuara.
- ✚ Rakordimi i informacionit të marrë nga pikat e kontaktit pranë Drejtorive të Financës, të institucioneve përkatëse, përpara momentit të raportimit pranë Ministrisë së Drejtësisë.
- ✚ Rritja e ndërgjegjësimit të institucioneve përgjegjëse të përfshira në Planin e Veprimit lidhur me rëndësinë që paraqet puna e vazhdueshme për zbatimin e duhur dhe në kohë të PV, si dhe mbi rëndësinë e procesit të raportimit.

